

**VENDIM**  
**Nr. 60, datë 23.4.2015**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “PËRPARIMI SK” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “SHTIKA”**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”; 9 dhe 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 13 dhe 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.4.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Përparimi SK” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie, me fuqi totale 1.3 MW,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Përparimi SK” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

Neni 9, pika 1. Format i aplikimit është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 2. Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.1. Të dhëna specifike për HEC është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.2. Të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.3. Dokumentacioni teknik dhe grafik është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.4. Dokumentacioni teknik- ekonomik është plotësuar në mënyrë korrekte.

Neni 9, pika 4.1.5. Leje nga institucione të tjera është plotësuar tërësisht.

Për gjitha sa më sipër, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Përparimi SK” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shtika” me fuqi totale 1.3 MW.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**